

V E N D I M
Nr.356, datë 25.3.1996

**PËR RREGULLIMIN E KOHËS SË PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË HOTELET,
RESTORANTET DHE NË NDËRMARRJET QË PLOTËSOJNË NEVOJAT E TURIZMIT**

Në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit dhe Turizmit dhe të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në hotelet, restorantet dhe kafenetë kohëzgjatja javore maksimale e punës është:

- a) 51 orë për kuzhinierët dhe pastabërësit;
- b) 60 orë për personelin e shërbimit;
- c) 57 orë për punëmarrësit e tjerë.

Për ndërmarrjet e vogla (të cilat punësojnë në mënyrë të vazhdueshme jo më shumë se 4 persona, pa llogaritur punëdhënësin, por duke llogaritur pjesëtarët e familjes së tij që punojnë me të, si p.sh. të afërmit e gjakut dhe bashkëshortet e tyre, fëmijët e tij dhe të bashkëshortit të tij), kohëzgjatja maksimale javore e punës mund të zgjatet deri në 6 orë në javë.

Për ndërmarrjet sezonale (të cilat qëndrojnë hapur vetëm një pjesë të vitit) kohëzgjatja javore mund të zgjatet 6 orë për 8 javë, por jo më shumë se 2 herë në vit.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e orëve shtesë. Numri i këtyre orëve nuk duhet të kapërcejë 20 orë në muaj dhe as 120 orë në vit për çdo punëmarrës.

Pushimi ditor i punëmarrësve duhet të zgjatë të paktën 9 orë pa ndërprerje dhe të përfshijë një nga intervalet e orëve 22.00 deri në 5.00 apo 1.00 deri në 8.00.

Punëmarrësit që punojnë në para orës 5.00 ose pas orës 1.00, duhet të kenë një pushim ditor të paktën 10 orë pa ndërprerje, i cili duhet të jepet menjëherë para ose pas punës.

Për personelin e shërbimit, pushimi ditor që paraprin pushimin javor, mund të reduktohet në 8 orë. Nëse ka punë urgjente apo rritje të pazakontë të vëllimit të punës, punëdhënësi, me pëlqimin e punëmarrësit mund ta zvogëlojë pushimin ditor të parashikuar më sipër.

Punëmarrësit duhet të kenë çdo javë një pushim javor të paktën 24 orë pa ndërprerje. Ky pushim duhet të korrespondojë me një të diel të paktën 1 herë në muaj.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë të punuarit natën dhe të dielave.

2. Në ndërmarrjet e rajoneve turistike dhe kufitare që plotësojnë nevojat e turizmit, si p.sh. shitoret, laboratorët fotografikë etj., puna nuk mund të zgjatet pas orës 22.30.

Pushimi i natës duhet të zgjatë të paktën 10 orë pa ndërprerje. Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e punës të dielave dhe natën.

Në këtë rast jepet një shtesë mbi pagën prej 25 për qind për punën e kryer ditën e diel dhe 50 për qind për punën e kryer natën.

3. Për personelin e shitjes (shitës fiks ose ambulant), personelin e shërbimit dhe atë të ndihmës së kioskave dhe ndërmarrjeve të tjera që plotësojnë nevojat e turizmit, puna mund të fillojë në orën 500 dhe të vazhdojë deri në orën 2300.

Hyjnë në këtë grup:

- a) kioskat dhe shërbimet e tjera të shitjes të instaluara në stacione treni ose aeroporte;
- b) kioska të vendosura pranë stacioneve të ndërmarrjeve të transportit publik, në rrugë dhe sheshe publike, në ekspozita ose panairë, si dhe me rastin e festave;
- c) ndërmarrjet që ofrojnë shërbime të stacionit të trenit dhe aeroportet, si dhe pranë stacioneve të ndërmarrjeve të transportit publik.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë kryerjen e punës natën, por në këtë rast puna e natës duhet të kufizohet në veprimtaritë e mëposhtme:

- shitja në kioska dhe në shërbimet e tjera të shitjes, si dhe nëpër stacionet e trenit dhe aeroportet;
- shfrytëzimi i ndërmarrjeve të përmendura më sipër në pikën “c”;
- bërja e një inventari.

Kohëzgjatja ditore e punës nuk duhet të kapërcejë 10 orë dhe duhet të përfshihet me gjithë pushimet në një interval kohe prej 12 orësh.

Kur punëmarrësit kalojnë nga shërbimi i ditës në atë të natës, pushimi i tyre ditor mund të reduktohet në 7 orë një herë në 2 javë, me kusht që përpara se të rifillojnë shërbimin e natës, ata të kenë një pushim të zgjatur në një masë të mjaftueshme për të kompensuar reduktimin.

Punëdhënësi ka të drejtë të urdhërojë punën të dielave.

Punëmarrësi duhet të ketë të paktën një të diel pushim në 4 javë.

4. Në të gjithë sektorët e mësipërm puna duhet të ndërpritet nga pushime minimumi:

15 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 5 orë e 30 minuta.

30 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 7 orë, dhe 60 minuta, nëse dita e punës zgjat më shumë se 9 orë.

Pushimet llogariten si kohë pune, në rastin kur punëmarrësi nuk është i autorizuar të largohet nga vendi i punës gjatë këtyre pushimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi